



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Data 03/11/2023

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: HARTIM PROJEKTI " NDËRTIM I PALESTRËS SPORTIVE  
TË SPORTIT BERAT "**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
Projekte:22114311-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 14 456 027,33 ( katermbedhete milion e katerqind e pesedhete e gjashtemije e njezete e shtate presje tridhete e tre )

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

### DREJTORIA JURIDIKE

Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është “Sherbim Konsulence”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku përcaktohet se: “40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020,2021,2022 që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa “c”,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA JURIDIKE

të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr.1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**2.3** Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kesaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

**2.3.1** Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim ), ku të përfshihen kategorite:

1. PROJEKTUES URBANIST



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

c) Plane te detajuara vendore

**2.PROJEKTUES ARKITEKT**

- a) Projektim arkitekturor per objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike;
- b-1) Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara;
- b-2) Qendra tregtare, objekte social-kulturore;objekte kulti;objekte arsimore;
- d- Projektim peisazhi,sistemim siperfaqe te gjelberta,lulishte e parqe.

**3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- a) Projektim objekte civile – industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate;
- b) 1.Objekte civile-industriale-turistike mbi 5 kate -2.objekte me skelet metalik;
- c) 1. Objekte me shkalle te larte veshtiresie Beton arme – metalike;
- d) Vleresimi i kapacitetit mbajtes dhe perforecim i strukturave mbajtese prej beton-arme,murature dhe metalike;
- e) Projektim objekte civile e turistike prej druri;

**4.PROJEKTUES INSTALATOR**

- a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;
- b) Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;
- c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;
- f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit;
- g) Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa;
- h) Projektim i impianteve ngritese e transportuese ( ashenore,shkalle levizese, etj);
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ,ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive etj;
- j) Projektim te rrjeve te tefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj per objektet civile dhe industriale.

**5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**

- b) Projektim furnizim me uje – kolektore shkarkimi.

**8. PROJEKTUES GJEODET**

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale
- c) Sistemet GIS

**9. STUDIME GJEOLLOGOJIKE INXHINIERIKE-HIDROGJEOLOGJIK**

- a) Studim/vleresim gjeolog-inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike deri 5 kate;
- b) Studim/vleresim gjeolog-inxhinierik i truallit per objekte vicile – ekonomike mbi 5 kate;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

**10. PROJEKTIM I IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE**

e) Projektim kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem;

**11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR**

a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

d) Projektim Sinjalistike ndricuese ne infrastrukture;

**12. STUDIME TE SIZMOLOGJISE INXHINIERIKE**

b) Studime/vleresime gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore;

c) Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore dhe hekurudhore te te gjitha llojeve, ura, tunele,viadukte etj.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

KATEGORIA E KERKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISE	ARGUMENTIMI
1-c	Plane te detajuara vendore	Bazuar ne termat e references, per marrjen e lejes se ndertimit eshte e nevojshme hartimi i plan-vendosjes per objekte te vecante te cilat jane ne trajten e pdv pikesore dhe si rrjedhoje, gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
2-a	Projektim arkitekturor per objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike	Bazuar ne termat e referencespalestrat sportive kane ambiente sherbimi dhe teknike te ruajtjes dhe funksionimit. Keto trajtohen si elemente industrial dhe si rrjedhoje, gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
2-b1	Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara	Bazuar ne termat e references, objekti eshte objekt sportiv dhe si rrjedhoje, gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

2-b2	Qendra tregtare; objekte social- kulturore; objekte kulti; objekte arsimore	Bazuar ne termat e references, palestra sportive ka te integruar hapësira social kulturore dhe si rrjedhoje, gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
2-d	Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe	Bazuar ne termat e references, palestra sportive kane nevojte per projektimin e oborreve dhe si rrjedhoje, gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
3-a	Projektim objekte civile-industriale- turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate	Bazuar ne termat e references, objektet sportive mund te kete nje lartesi 3-4 kate dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
3-b	Objekte vicile- industriale- turistike mbi 5 kate. 2.Objekte me skelet metalik	Bazuar ne termat e references, objektet sportive mund te kete nje lartesi 1-6 kate dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
3-c1	1.Objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme-metalike	Bazuar ne termat e references, palestra ka hapësire te konsiderueshme drite te cilat jane struktura me shkalle veshtiresie qofshin keto beton arme apo struktura metalike dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
3.d	Vleresimi i kapacitetit mbajtes dhe perforecim i strukturave mbajtese prej beton- arme,murature dhe metalike;	Bazuar ne termat e references, godina e cila duhe te projektohet duhet ti nenshtrohet analize se thelluar ne lidhje me vleresimin e kapaciteteve gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
3-e	Projektim objekte civile e turistike prej druri	Bazuar ne termat e references,palestra sportive ne sistemimet e jashtme mund te kete struktura hijezuese prej druri dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-a	Projektim te instalimeve hidro-	Bazuar ne termat e references, godinat pjese e projektit parashikohen per funksionin qe do te kryejne te kene



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

	termosanitare	sisteme te plot ate instalimeve hidro sanitare ( tualete, furnisim me uje etj) si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-b	Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme	Bazuar ne termat e references, godinat do te propozohen te kene panvaresi te sistemeve elektrike ndermjet prodhimit te saj nga impiante te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme si psh panelet diellore, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-c	Projektim te linjave e rrjeteve elektrike per objekte civile e industriale	Bazuar ne termat e references, godina pjese e projektit, per funksionin qe do te kryeje te kene sisteme te plot ate instalimeve elektrike, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-f	Projektim te sistemeve kundra zjarrit	Bazuar ne termat e references, godina pjese e projektit te rehabilitimit parashikohet te jete i pajisur me sisteme kundra zjarrit dhe sidomos ne situatat e renduara gjate sezonit te veres keto siperfaqe ujore mund te sherbejne si depozita natyrore per shuarjen e zjarreve, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-g	Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industry dhe ndertesa	Bazuar ne termat e references, palestra sportive kane domosdoshmeri sistemet e monitorimit dhe automatizimit dhe integrimin te sistemeve, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-h	Projektim i impianteve ngritese e transportuese ( ashensore, shkalle levizese etj )	Bazuar ne termat e references, palestra sportive kane ashensore si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
4-i	Projektim i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ,	Bazuar ne termat e references, parashikohet realizimi i shesheve dhe ambienteve rekreativ te cilat do te kene ndricim, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

	ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve, aeroporteve etj .	kerkuara.
4-j	Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, CCTV etj	Bazuar ne termat e references, godina pjese e projektit te rehabilitimit ne kuader te kesaj procedure do te jene te pajisura me te gjitha sistemet teknike te nevojshme per funksionet qe do te realizoje perfshire, sistemet e internetit, kamerat e sigurise, sistemet e alarmit per dedektimin e zjarrit etj, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
5-b	Projektim furnizim me uje kolektore shkarkimi	Bazuar ne termat e references, per realizimin e objekteve te parashikuar, parashikohet realizimi i kolektoreve te shkarkimit, furnizimi me uje, etj , si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
8-a	Rilevime inxhinierike	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e rilevimeve te gjendjes ekzistuese te godines, rrugeve, shesheve etj si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
8-b	Rilevime inxhinierike kadastrale	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin kadastral te rrugeve, shesheve etj te gjitha infrastrukturen e siper permendur si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
8-c	Sistemet GIS	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e rilevimeve duke perdorur sistemin GIS te gjendjes ekzistuese, rrugeve, shesheve etj te gjitha infrastrukturen e siper permendur si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
9-a	Studim/vleresim gjeologo inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike deri 5 kate	Bazuar ne termat e references, palestra sportive mund te kete nje lartesi 1-6 kate ( 18-20 m) dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
9-b	Studim/vleresim	Bazuar ne termat e references, palestra sportive mund te



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

	gjeologo inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike mbi 5 kate	kete nje lartesi 1-6 kate ( 18-20 m) dhe si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
10-e	Projektim kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem.	Bazuar ne termat e references objektet dhe impiantet e infrastruktures qe parashikohen te realizohen ose rikonstruktohen do te furnizohen me energji elektrike ashtu si kurse dhe ndricimi rrugor, furnizim ky i cili do te sigurohet nga realizimi i kabinave elektrike me linja te tensionit te ulet dhe te mesem per furnizim, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
11-a	Projektim sinjalistike jo ndricuese, ne rruge locale, rruge urbane dytesore etj	Bazuar ne termat e references meqenese si pjese e projektit parashikohet realizimi i rrugeve, parkimit dhe shesheve te brendeshme eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalistikes jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal si pjese integrale e projekteve te infrastruktures rrugore e jo vetem, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
11-d	Projektim sinjalistike ndricuese ne infrastrukture	Bazuar ne termat e references, parashikohet qe te behet parkimi perfshire edhe pajisjen me sinjalistike ndricuese te tij, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
12-b	Studime/vleresime gjeologo – sizmike per trojet ku ndertohen objekte civile, sociale e kulturore	Bazuar ne termat e references, kerkohej domosdoshmerisht vleresimi dhe studimi sizmik per vleresimin e kapaciteteve per te percaktuar skemen e nderhyrjes, si rrjedhoje gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimeve te kerkuara.
12-c	Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore dhe hekurudhore te te gjitha llojeve, ura,	Bazuar ne termat e references, parashikohet te realizohen parkimi, rruge te brendeshme, sheshe dhe siperfaqe rekreative, si rrjedhoje vleresimi sizmik per kete kategori eshte i justifikuar pasi do te kemi te bejme me vepra te infrastruktures rrugore per te cilat pritet te kete dhe integrim me infrastrukture ekzistuese etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA JURIDIKE

	tunele etj.	
--	-------------	--

**2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:**

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

**Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, CV dhe Diplomë .**

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)*

Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika4/b te VKM nr.2285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomik te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates specialisti i fushes anetar i njesie e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

prokurimit për vendosjet e stafit i është referuar termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekti i kësaj procedure, si objektet e një kategorie të vecante për të cilën gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekta godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një ze i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) gjeodet** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të studimeve gjeologjike dhe hidrollogjike që parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri gjeolog/Hidrollogjik**, si pjesë e stafit teknik.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet të ketë ashensor, sisteme të ngrohjes nevojitet që për hartimin e projekteve të kemi prezencën e **Ing. Mekanik**.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet parashikohet të ketë sisteme të vezhgimit të kamerave, sisteme audio vizive, rrjetin data të internetit etj nevojitet të kemi prezencën e **Ing Elektronik**.

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi/Strukturist;
- 1 (një) Inxhinier gjeoteknik/gjeofizik/sizmiolog

Për punonjësit e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

**Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV dhe license**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)*

Argumentim: Ne baze të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr.2285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Meqëse kemi të bëjmë me ndertimin e një objekti kompleks siç janë spallati i sportit prezenca e stafit të mesiperm është gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht :

- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të paisazhit subjekti i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilën gjykohej si e nevojshme prezenca e të paktën 1 ( një ) Arkitekteve si staf ndihmes ( arkitekthe godinash, paisazhi etj) .
- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohej dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit strukturist do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohej që duhet të paktën 1 (një) inxhinier ndertimi profili strukturist pjesë e stafit ndihmes.
- Punimet për shërbimet që ofrohen nga inxhinieri gjeoteknik/gjeofizik/sizmiolog bazuar pikave të licenses se kërkuar konkretisht për punime dhe vlerësime të inxhinierisë gjeologjike-sizmike, vlerësimet gjeoteknike të trojeve do të jenë të nevojshme të realizohen, konkretisht në këto objekte meqëse kemi ndertesa të reja si dhe vlerësim të gjendjes së godinës ekzistuese lind nevoja e prezencës së 1 një specialisti inxhinier gjeoteknik/sizmiolog/inxhinier gjeofizik si staf ndihmes për kategorinë e sipërcituar për vlerësimin gjeoteknik – sizmiologjik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

**2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te kontraktuar eksperte si me poshte:**

- 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis;
- 1 (nje) Auditues energjistik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;
- 1 (nje) Ekspert Zjarrefikes

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

**Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV, Certifikatat perkatese ( te vlefshme) dhe license.**

Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika4/b te VKM nr.2285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomik te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates specialisti i fushes anetar i njesie e prokurimit per vendosjet e stafit i eshte referuar termave te pergjithshme te references per objektet pjese e kesaj procedure, pjese e secilave do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen. Meqense kemi te bejme me ndertimin e nje objekti kompleks sic jane shkollat prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht :

- Eksperi zjarrefikes eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vleresimeve perkatese te fushes bazuar ne termat e references.
- 1 Auditues Energjistik i certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne ndertesa per realizimin e certifikates se eficenses se energjise.
- 1 punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vkeresimin e Ndikimit ne Mjedis gjykohet si i domosdoshem per realizimin e VNM ( Vleresime e ndikimit ne mjedis) per projektet qe do te realizohen.

**Shënim:** Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA JURIDIKE

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)*

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 14 (pesëmbëdhjete) punonjës për muajin e fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit të deklaruar.
- b) Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit të deklaruar.

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatoret ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Certifikatat të pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise ose ekuivalente;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit ose ekuivalente;
- c) ISO 45001:2018, sistemi i Menaxhimit per shendetin dhe Sigurine ne Pune ose ekuivalente;
- d) ISO 50001-2011, sistemi i menaxhimit te Energjise ose ekuivalente;

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Certifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pajisje si me poshte në pronesi ose me qera:**

- 1- Pajisje për matje gjeodezike GPS;
- 1- Pajisje për matje gjeodezike total Station

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA JURIDIKE**

Mjetet e mesiperme janë vendosur në përputhje me natyrën e Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave

- 1- Pajisje për matje gjeodezike GPS; i domosdoshëm për matjet dhe piketimet gjeodezike
- 2- Pajisje për matje gjeodezike total Station- matjet, kuotat në mënyrë me të detajuar në objekt, piketimet gjeodezike.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

- Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës, duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA JURIDIKE

**Termat e referencës janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdher të titullarit për hartimin e termave të referencës, preventivit dhe llogaritjes së fondit limit**

***Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

**NJESIA E PROKURIMIT**

**Specialist i fushës**  
**Ergis Senka**

**Jurist**  
**Fjoralda Arapi**

**Specialiste (Ekon)**  
**Ardisa Zhuka**

**MIRATOHET**  
**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**ERVIN DEMO**